




5 PARAQITËSI

Paraqitësi është pjesë përbërëse e ndërfaqes së përdoruesit, që mundëson kontrollin e regjistrimit bibliografik ose regjistrimeve, të cilat janë të lidhura me të. Mund të shfaqet një ose më shumë regjistrime bibliografike njëherësh.

Elementet e paraqitësit:

- shiriti i titullit
- ikonat  **Prapa** dhe  **Përpara**, të cilat janë aktive kur regjistrimi bibliografik ka edhe regjistrime të tjera të lidhura
- ikonat  **I mëparshmi** dhe  **I ardhshmi**, të cilat shfaqen nëse keni hapur paraqitësin për disa regjistrime bibliografike njëherësh
- skedat **Formati bazë**, **MARC** dhe **Formati standard**, të cilat mundësojnë shfaqjen e regjistrimit të përzgjedhur bibliografik në formate të ndryshme
- pjesa e dritares në të cilën është shfaqur regjistrimi bibliografik
- pjesa e dritares, në të cilën janë të shfaqura objektet e lidhura me regjistrimet e përzgjedhura bibliografike
- butonat
 - **Kapaku** – shfaqja e kapakut të materialit
 - **Hap** – për shfaqjen e regjistrimit të lidhur në të njëjtin paraqitës
 - **Dritare e re** – për shfaqjen e regjistrimit të lidhur në paraqitës të ndarë
 - **Printo** – për printimin e regjistrimit bibliografik
 - **Gjej** – kërkimi në regjistrimin bibliografik
 - **Mbyll** – për mbylljen e paraqitësit të caktuar
 - **Mbyll të gjitha** – për mbylljen e të gjithë paraqitësve




Figura 5-1: Paraqitësi

Paraqitësin mund ta hapni në shfletues ose në dritaren për kërkim.

Procedura

Dalja nga dritarja për kërkim.

1. Paraqitësi hapet duke përzgjedhur regjistrimin bibliografik midis rezultateve të kërkimit dhe duke klikuar butonin **Shfaq**.

Hapet dritarja **Paraqitja – Regjistrimi bibliografik – numri rendor nn**, në të cilën regjistrimi i përzgjedhur bibliografik paraqitet në formatin, në të cilën e keni kontrolluar së fundmi regjistrimin (formati bazë, MARC, formati standard).

Nëse klikoni skedën **Formati bazë** (shih kap. 5.1), mund të shihni regjistrimin bibliografik në formën e listë së attributeve. Në skedën **MARC** paraqitet regjistrimi në formatin COMARC/B (shih kap. 5.1). Nëse dëshironi të shihni formatin e shfaqjes sipas ISBD-së, duhet të klikoni skedën **Formati standard** (shih kap. 5.3).





Regjistrimet ose objektet e tjera, të cilat janë të lidhura me regjistrimin e përzgjedhur shfaqen në pjesën e dritares **Objektet e lidhura**.

2. Nëse dëshironi të kontrolloni kapakun e materialit, klikoni butonin **Kapaku**. Kapaku shfaqet vetëm nëse ekziston në COBISS+.
3. Nëse dëshironi të shihni regjistrimin ose ndonjë objekt tjetër, i cili është i lidhur me regjistrimin që po kontrolloni, atë fillimisht duhet ta përzgjidhni në listën e objekteve të lidhura dhe më pas të klikoni butonin **Dritare e re**. Regjistrimi i përzgjedhur do të shfaqet në paraqitës të veçantë. Nëse regjistrimin dëshironi ta shfaqni në të njëjtin paraqitës (dhe me këtë të mbulon regjistrimin të cilin po e kontrolloni), klikoni butonin **Hap**.



Këshillë:

Regjistrimin bibliografik të lidhur mund ta kontrolloni edhe duke klikuar dy herë mbi të. Regjistrimi i përzgjedhur shfaqet në dritaren ekzistuese.

4. Midis regjistrimeve të lidhura bibliografike, të hapura në të njëjtin paraqitës, mund të lëvizni *prapa* me ikonën , ndërsa *përpara* me ikonën .
5. Nëse në dritaren për kërkim keni përzgjedhur disa regjistrime bibliografike dhe keni hapur paraqitësin, në regjistrimin *e mëparshëm* mund të shkoni përmes ikonës , ndërsa në regjistrimin *e ardhshëm* përmes ikonës .
6. Nëse regjistrimin bibliografik dëshironi ta printoni, klikoni butonin **Printo**.



Shënim:

Për printimin e duhur, në kompjuter duhet të instaloni programin Java, versionin 1.6 ose më të ri.

7. Nëse dëshironi që në regjistrimin në formatin MARC të gjeni një tekst të caktuar, klikoni butonin **Gjej**. Shënoni termin për kërkim dhe klikoni në butonin **Në rregull**. Teksti i kërkuar brenda regjistrimit merr ngjyrë të kaltër.

8. Për ta mbyllur paraqitësin klikoni butonin **Mbyll**. Nëse regjistrimin e lidhur e keni hapur në paraqitës të veçantë, të gjithë paraqitësit mund t'i mbyllni njëherësh duke klikuar butonin **Mbyll të gjitha**.

Nëse ndryshoni madhësinë e dritares së paraqitësit, madhësia e re ruhet pas mbylljes së tij dhe është e vlefshme deri në ndryshimin e radhës.

Nënkapitujt:

- Formati bazë
- Formati MARC
- Formati standard